



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:000187

Datë: 02.02.2021

Numri i dokumentit: 01464889

P.nr.1/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. S., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4636/20 të dt.30.12.2020, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 29.01.2021, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Blerim Igrishta dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë në prani të palëve mori publikisht dhe shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 02.02.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

SH. S., nga i ati I. dhe nëna B., mbiemri i vajzërisë së nënës H., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin Ll., Komuna e Podujevës, me numër personal të identifikimit:..., ka të kryer shkollën e mesme, profesioni bujk, i martuar baba i 3 fëmijëve i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, Shqiptar–Kosovar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Që nga janari i vitit 2020, në vazhdimësi deri me datë 13.10.2020, rreth orës 19:00, në lokalimarketin “F...” SH.P.K, e cila gjendet në fshatin Sh., Komuna e Podujevës, i pandehuri me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm kishte vjedhur artikuj të ndryshëm ushqimor si aerokrem, pashteta, në lokalimarketin e lartcekur, duke i vendosur ato në xhepa të palltos dhe të pantallonave, me çka të dëmtuarit, pronarit të marketit “F.”, F. A., i ka shkaktuar dëm material.

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 77 dhe neni 313 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 369, 370, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj si dhe dënim me gjobë në shumën prej 100 (njëqind/€uro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

I dëmtuari: F. A. nga fshati Sh., Komuna e Podujevës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.4636/20 të dt.30.12.2020, kundër të akuzuarit Sh. S., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 29.01.2021, në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Blerim Igrishta nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë është e vërtet si në aktakuzë, jam penduar shumë, gjendjen ekonomike e kam shumë të vështirë, i kam marur për fëmijët e mijë se nuk kam pasur mundësi që ti paguaj, është hera e parë që jam para gjykatës, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe gjykatës.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga e akuzuara deklaroi: E pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit u bë me vullnetin e tij të plotë pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të nenit 248 të KPPRK-së, andaj i propozoj gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuari përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 par. 1 KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtores dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se e akuzuara gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, jeton në kushte të rënda ekonomike, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesën nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par. 4 KPPRK-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht, i njëjti gjykatës ia ka dorëzuar në kopje të kartelës së ndihmës sociale me numër të regjistrimit 25194.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.1/2021 me dt. 02.02.2021**

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.